




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale  
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale  
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë, 21.03.2019

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale, neni 51, “Shtyrjet dhe përjashtimet” paragrafi 1, Rentat minerare nuk paguhen për mostrat e mineraleve të nxjerra me qëllim të kryerjes së analizave kimike ose teknologjike. Meqenëse neni 51, paragrafi 1 nuk e kufizon sasinë e nevojshme dhe të lejuar për përgatitjen e mostrave për kryerjen e analizave kimike dhe teknologjike, atëherë Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale mbi bazën e nenit 62 paragrafi 6 nxjerr këtë:

### V E N D I M PER ANALIZA KIMIKE DHE TEKNOLOGJIKE

Ndërmarrjet e licencuara apo me leje për aktivitete të veçanta në KPMM, qoftë për hulumtim, shfrytëzim apo përpunim të lendeve minerale bazuar në Ligjin Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale, neni 51 paragrafi 1 që për kryerje të analizave kimike ose teknologjike u lejohej sasia deri në 300 ton mineral në gjendje natyrore pa paguar rentën minerare.

Ndërmarrjet e lartcekura mund të kërkojnë sasinë e mineralit në gjendje natyrore edhe mbi këtë vlerë (mbi 300 ton), mirëpo për diferencën janë të obliguar të paguajnë rentën minerare.

Analizat kimike dhe analizat teknologjike mund të kryhen brenda dhe jashtë vendit në institucionet e akredituara për këto lloje të shërbimeve. Ndërmarrjet janë të obliguara që rezultatet e analizave kimike dhe teknologjike të dorëzojnë Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

#### Arsyetim

Ligji Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale neni 51, “Shtyrjet dhe përjashtimet” paragrafi 1 nuk e specifikon sasinë e nevojshme të mineralit (mostrave) për kryerje të analizave kimike ose teknologjike, për të cilën sasi rentat minerare nuk paguhen. Bazuar në përvojat e tanishme dhe të së kaluarës, Bordi i KPMM-së mbi bazën e kompetencave të tij bazuar edhe në nenin 62 paragrafi 6, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Musa Shabani

Prishtinë, më 21.03.2019

Kryesues i Bordit  
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Rr. Armend Daci Nr.1  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (38) 240 252  
Fax: +383 (38) 245 844  
E-mail: [ICMM@kosovo-mining.org](mailto:ICMM@kosovo-mining.org)  
Web: [www.kosovo-mining.org](http://www.kosovo-mining.org)

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo